



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3458 prot.

Vlorë, më 21 03 2023

PROJEKT -VENDIM

Nr. _____ , datë ____ . ____ . 2023

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGJA E BANESËS TË Znj. TEFTA SELIMLLARI NË DATËN 26.12.2022, DHE
SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga diegia në banesën e znj.Tefta Selimllari, e ndodhur në lagjen “24Maj”,Rruga “Osman Haxhiu”, Rajoni Nr 4 Bashkia Vlorë, në datën 26.12.2022 ,sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- 57.347 (pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë për punime ndërtimi.
(114.695x50%)

● 211.590(dyqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

Koneptoi:E.Kamberi

Miratoi:O.Bejto

KRYETARI

Dritan LELI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 3458 prot.

Vlorë, më 21.03 2023

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E ZNJ.TEFTA SELIMLLARI NË DATËN 26.12.2022 DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë, në datën 27.12.2022 ka paraqitur kërkesën znj. Tefta Selimllari me Nr.16577 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "24 Maji", Rruga “Osman Haxhiu”, Rajoni Nr.4 Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr. 3 datë 13.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të proces verbalit të konstatimit të gjendjes në datë 28.12.2022, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.250 prot, date 10.01.2023 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të Znj.Tefta Selimllari”, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.250/1, datë 30.01.2023 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të Znj.Tefta Selimllari në lagjen "24 Maji" Vlorë, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

1.Vlera e dëmeve në banesën e Znj. Tefta Selimllari është 268.937(dyqind e gjashtëdhjet e tetë mijë e nëntëqind e tridhjet e shtatë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjen për banesën e djegur.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Znj. Tefta Selimllari në datën 26.12.2022 sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile i Bashkisë Vlorë.

Përgjegjës i Sektorit të Kompesimit

OLTJAN BEJTO

